



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:012176

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06495792

C.nr. 35/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoreshen profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.V nga Rahoveci, M.G nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit dhe F.V nga Rahoveci, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati A.M nga Rahoveci, Rr. ... kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike për kompensim i ushqimit në punë si dhe shpenzimet e udhëtimit, vlera e objektit të kontestit 2,214.00 euro, jashtë seancës, më datën 22.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkespacia e paditësve: B.V, M.G dhe F.V.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit B.V, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 09.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 345 ditë pune të ja paguajë shumën prej 690.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 09.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses M.G, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 03.09.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 230 ditë pune të ja paguajë shumën prej 460.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, po ashtu në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore prej datës 03.09.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 230, ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 2 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 1.40 euro të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 322 euro, apo shumën e përgjithshme për të dyja kërkesa, në shumën prej 782.00 euro me kamatë

ligjore me kamatë ligjore 8% nga data 09.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit F.V, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 09.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 173 ditë pune të ja paguajë shumën prej 346.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 09.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- V. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkespadiisë së paditësit B.V për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 690.00 euro e deri në shumën prej 780.00 euro dhe atë në shumën prej 90.00 euro.
- VI. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkespadiisë së paditëses M.G për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 782.00 euro e deri në shumën prej 998.00 euro dhe atë në shumën prej 132.60 euro.
- VII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkespadiisë së paditësit F.V për pjesën tjetër të padisë lidhur me kompesnsimin e ushqimit në punë mbi shumën prej 346.00 euro e deri në shumën prej 436.00 euro dhe atë në shumën prej 90.00 euro.
- VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës paditësve, B.V, F.V dhe M.G, t’i paguajë shumën prej 229,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

#### A r s y e t i m

Paditësit: B.V, M.G dhe F.V, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, më datën 09.01.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit të ushqimit në punë, vlera e kontestit 2,214.00euro.

Të njëjtit sipas padisë kanë theksuar se paditësit: B.V, M.G dhe F.V, kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë si mësimdhënës në SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec. Pos të drejtave tjera të parapara me dispozitat e Ligjit të Punës, nr.03/L-2012, si dhe nga kontratat e punës, paditësve si punëtorë arsimorë e në mbështetje të nenit 35.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, 01, numri i protokollit 105, prej datës 22.01.2021 “ u takojnë shpenzimet e udhëtimit si dhe në bazë të dispozitave të nenit 35.7, paditësve u takojnë shpenzimet e ushqimit, e që e paditura sot e kësaj dite nuk i ka kryer detyrimet e veta ndaj paditësve.

Paditësit me qëllim të realizimit të këtyre të drejtave, me kërkesë të veçantë, numri i protokollit 6463, prej datës 15.12.2023, iu janë drejtuar Drejtorit të Drejtorisë për Arsim të Komunës së

Rahovecit, mirëpo nga ana e drejtorit, as sot e kësaj dite nuk kanë marrë përgjigje. Andaj i kanë propozuar gjykatës që kërkespadinë ta aprovojë si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 26.06.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Në bazë të nenit 87 të Ligjit të punës “Të gjitha kërkesat në para nga mardhënia e punës parashkruhen në afat pre tre (3) vitesh.

E njëjta ka theksuar që i konteston vërtetimet në formë të kuponave fiskal apo vërtetimet të cilat i nxjerrin shoqatat e transporteve, ngase këto shoqatat nuk janë kompetente për caktimin e çmimit të udhëtimeve.

Paditësi me padi ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë, të cilën e konteston në ëtrësi, sepse konsideron se kamata duhet të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, respektivisht nga dita kur paditësve u njihet e drejta e kompensimit, kur edhe e paditura kuton në bazë të aktgjykimit lidhur me detyrimet financiare që i ka ndaj paditësve. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr.03/400 i datës 30.11.2023, i lëshuar nga SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec për paditësin B.V; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit:42/2015, e datës 09.10.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit B.V;

Për paditësen M.G, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 03/420 i datës 11.12.2023, i lëshuar nga SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec; kontratën e punës për mësimdhënës, me Nr të protokollit: 897 e datës 03.09.2021, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses M.G; kontratën e punës për mësimdhënës, me Nr të protokollit: 04/457 e datës 01.09.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses M.G; vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit dhjetor 2023, i lëshuar nga “Shoqata e Transportit-Kosova e Lirë” në Prizren për paditësen M.G.

Për paditësin F.V, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 03/426 i datës 13.12.2023, i lëshuar nga SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec; kontratën e punës si

mësimdhënës, me Nr të protokollit: 83 e datës 01.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit F.V; kontratën e punës si mësimdhënës, me Nr të protokollit: 471 e datës 01.09.2021, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit F.V; kontratën e punës si mësimdhënës, me Nr të protokollit: 839/22 e datës 10.10.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit F.V;

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit për periudhën e kërkuar kohore kanë prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve pagesa e ushqimit dhe udhëtimit për çdo ditë të prezencës në punë dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr.03/400 i datës 30.11.2023, i lëshuar nga SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.V në periudhën kohore prej datës 01.01.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 351 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit:42/2015, e datës 09.10.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit B.V, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec.

Me administrimin vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 03/420 i datës 11.12.2023, i lëshuar nga SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M.G në periudhën kohore prej datës 03.09.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 230 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës, me Nr të protokollit: 897 e datës 03.09.2021, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësës M.G, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës, me Nr të protokollit: 04/457 e datës 01.09.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësës M.G, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec.

Me administrimin e vërtetimit e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit dhjetor 2023, i lëshuar nga “Shoqata e Transportit-Kosova e Lirë” në Prizren për paditësen M.G, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Xërxë-Rahovec si dhe anasjelltas është 2 euro në dy drejtime.

Me administrimin vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr.03/426 i datës 13.12.2023, i lëshuar nga SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi F.V në periudhën kohore prej datës 01.01.2021 e deri më 21.11.2022, ka prezantuar në punë në 179 ditët e punës.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës, me Nr. të protokollit: 83 e datës 01.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit F.V, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës, me Nr. të protokollit: 471 e datës 01.09.2021, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit F.V, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec.

Me administrimin e kontratën e punës për mësimdhënës, me Nr. të protokollit: 839/22 e datës 10.10.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit F.V, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec.

Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësve për faktin se paditësit në vendin e tyre të punës kanë prezantuar, paditësi B.Vpër periudhën kohore nga data 09.01.2021 deri më 21.11.2022 për 345 ditë të punës, paditësja M.Gpër periudhën kohore nga data 03.09.2021 deri me datën 21.11.2022 për 230 ditë pune, si dhe paditësi F.Vpër 173 ditë pune. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësit kanë qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti e ka kontestuar e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë.*

*Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”. Për paditësin B.V në rast se shumëzohen 345 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 690.00 euro, për paditësen M.G në rast se shumëzohen 230 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 460.00 euro, për paditësin F.V në rast se shumëzohen 173 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 346.00 euro.*

Ndërkaq sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Për paditësen M.G në rast se shumëzohen 230 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 2 euro për çdo biletë (70% i 2 euro = 1,40 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 322 euro.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë për paditësin B.V për 39 ditë të punës (në emër të shujtës) x 2 euro dhe atë shumën prej 78.00 euro, për paditësen M.G, për 39 ditë të punës (në emër të shujtës) x 2 euro dhe atë 78.00 euro, për shpenzimet e udhëtimit 39 ditët e punës x 1.40 euro i 70% të shumës prej 2 euro për çdo biletë, shumën prej 54.60 euro, si dhe për paditësin F.V, për 39 ditë të punës (në emër të shujtës) x 2 euro dhe atë shumën prej 78.00 euro, për periudhën kohore nga data 22.11.2022 e deri më datën 31.01.2023 pasi që sipas vlerësimit të gjykate Kontrata Kolektive vlen deri më 22.11.2022, pasi që nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, njëra palë kontraktuese më datën 22.11.2022 është tërhequr nga zbatimi i kësaj Kontrate Kolektive. Në këtë Kontratë Kolektive kanë qenë të parapara edhe hapat e kontestimit të shkëputjes së kësaj Kontrate, mirëpo nga pala tjetër nënshkruese nuk janë paraqitur prova me të cilën do ta dëshmonin se është kontestuar vlefshmëria e Kontratës Kolektive. Këtë qëndrim e mban edhe Gjykata Supreme e Kosovës, e cila në mendimin e saj juridik me numër 214/2023 të datës 05.10.2023, ka theksuar se *“Në rrethana të tilla, kjo gjykatë vlerëson se rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga kjo kontratë duhet trajtuar sipas kësaj kontrate dhe atë deri me datën 21.11.2022, kur është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese, marrë për bazë arsyet e paraqitura më lartë”*, prandaj gjykata vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Po ashtu gjykata ka vendosur ta refuzojë si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë të paditësve B.V, F.V me nga 12 euro, për periudhën prej datës 01.01.2021 e deri me datë 09.01.2021, për faktin se gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës

Gjykata vlerëson se baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 09.01.2024, prandaj gjykata vendosi si në piken II. Dhe IV. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të

obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqfituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën VIII. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 229,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 208.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.35/2024, më datën 22.11.2024

B.Profesionale  
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.